

Ikona dhe miniatura mesjetare në Shqipëri



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI», 1974

Teksti dhe materialet përgatitur nga: THEOFAN POPA

Fotograf: PLEURAT SULO

Për t'u futur drejt në rrethanat e zhvillimit të artit piktorial mesjetar shqiptar, duhet të mbahet parasysh se Shqipëria gjatë shekujve të mesjetës deri në pushtimin turk, me pak përjashtime, bënte pjesë në kuadrin e Perandorisë bizantine. Gjithashtu duhet mbajtur parasysh se Kisha në Shqipëri, në pjesën më të madhe të saj ka qenë e rritit lindor. Nëpërmjet të Kishës, në Shqipërinë e Mesjetës, bashkë me gjuhën kishtare greke, u përhapën edhe ndikimet e letërsisë fetare, të arkitekturës dhe të pikturës. Duke u nisur nga Kostandinopoja, që ishte kryeqyteti i Perandorisë këto ndikime, nëpër rrugët e mirënjohura të Selanikut e të Ohrit, futeshin nëpër qendra më të brendshme të vendit tonë, si ne Selasfor (Zvezdë), qendër lokale e krahinës së Korçës dhe Kolonjës, dhe në Berat, qendër lokale e Shqipërisë së mesme, trashëgimtare edhe e objekteve kulturore të qyteteve që rrënoheshin, ndër të cilët vlejnë të përmenden

Durrësi, Skampa dhe Glavenica.

Duhet ditur se thesari artistik i realizuar nga populli shqiptar gjatë mesjetës, sidomos në artin e ikonave dhe atë të miniaturës së dorëshkrimeve, për shkak të rrethanave shumë të vështira, të njohura në histori, sot paraqitet thellësisht i reduktuar.

Në Shqipëri, në fushën e arteve figurative, veprat më të vjetra mesjetare, që kanë mundur të ruhen deri më sot, janë ato të miniaturës së dorëshkrimeve fetare, të cilat fillojnë nga kodet e shek. IX dhe vazhdojnë në kodet e çdo shekulli suksesiv, deri në shek. XIV, duke mos përfshirë këtu kodin më të vjetër të shek. VI, të njohur në literaturën speciale me emrin Codex Berantinus porpureus Φ , i cili ruan vetëm një dekor në formë zemre. Numri i këtyre kodeve nuk arrin sot në më shumë se 63 vëllime, duke mos llogaritur këtu dorëshkrimet e kohës së okupacionit otoman, që janë me pak të rëndësishme.

Këto dorëshkrime, që në përmbajtje, shprehin ideologjinë fetare të klasës sunduese feudale, nga ana tjetër përbëjnë dokumenta me rëndësi të madhe historike dhe janë thesarë të vërtetë për sa u përket vlerave artistike që kanë.

Përveç bukurisë së rrallë kaligrafike, ato janë të stolitur edhe me figura në miniaturë, me vinjeta, kanone e iniciale të pikturuara.

Miniatura e shek. IX e X në Shqipëri paraqitet e stilit grafik dekorativ, ku figurat janë ndërtuar në mënyrë skematike, prej linjash të drejta të thyera, dhe ku format e gjymtyrëve dhe pozicioni përcaktohet me anë linjash të lakuara, me siluetë e vizatim të sakët, realizuar me një finesë të theksuar. Në miniaturën e shek. X mënyra e trajtimit të figurave paraqitet më piktoreske, më plastike e me volum, me ngjyra të kultivuara, të përdorura me tone me gradacione. Këto miniatura nuk shquhen për shprehje të lartë artistike.

Në Shqipëri zhvillimin më të lartë miniatura e dorëshkrimeve mesjetare e arrin aty nga fundi i shek. XI ose fillimi i shek. XII, me miniaturën e dy kodeve tepër luksoze të Vlorës, ku bie në sy një sintetizim i elementeve të stilit bizantin, që sapo kishte arritur formimin e tij të plotë, me ato të traditës së artit antik.

Në miniaturën e kodeve të Vlorës vërehen tipa të sanksionuar në pikturën bizantine, rrethuar nga një ambient arkitektonik bizantin, kurse si portrete dhe në tërësi, figurat kanë një trajtim piktoresk e real, të modeluar me plastikë të plotë, të realizuar prej linjash të lakuara, pa konture të theksuara, me qëndrime të sakta, të ekuilibruara, me ngjyra të mirëkultivuara, të lehta, gracioze, me tone të përdorura me gradacione e mjeshtëri të larta: me lëvizje të matura dhe me vështrime të qeta por të menduara

thellë, elemente këto që njihen si të pikturës antike të shekujve të parë të erës sonë, por që vërehen edhe në miniaturën e shek. X të Kostandinopojës.

Realizimi i miniaturës së nivelit të lartë në Shqipëri përkon në kohë edhe në zhvillimin e gjinive të tjera të arteve figurative, si p.sh. me pikturën monumentale të shek. XII të Rubikut, me atë të shën Mërisë së Cerkës (Leskovik) etj., si dhe me ikonat më të vjetra që kanë mundur të ruhen deri më sot, siç janë ato të Beratit dhe ato të Korçës.

Riprodhimi në Shqipëri i kodeve mesjetare dhe i stolisjes së tyre me miniatura dhe vepra arti, dëshmon për një nivel të lartë kultural të vendit, sidomos për një pozitë të veçantë të aristokracisë feudale shqiptare gjatë shekujve të mesjetës. Kjo gjen mbështetje edhe tek mbishkrimet autografe të autorëve ose të piktorëve miniaturistë, që përmendin edhe porositësit e veprave.

Përsa u përket ikonave të pikturuara në dërrasë, që kanë mundur të ruhen deri me sot, ato më të hershmet i përkasin vetëm shek. XII. Në përgjithësi nga prodhimtaria e tri shekujve të fundit para okupacionit turk në Shqipëri nuk ruhen më tepër se rreth 30 copë ikona, nga të cilat pjesa më e madhe i përket shek. XIV.

Ikonat e Shqipërisë të shek. XII paraqiten të stilit kaligrafik bizantin dhe të një ndërtimi të lartë artistik, si në kompozimin në tërësi, si edhe në modelimin e detajeve në imtësi. Figurat përkufizohen prej një siluete të lehtë kafeje, e cila ecën në bazë të një linje të gravuar më parë mbi grundin e ikonës. Portretet modelohen me konture të buta kafeje mbi okrin e zbetë të karnacionit dhe sankir kafeje të errët.

Këto figura frontale ose gadi frontale, me qëndrime vertikale, me lëvizje të matura, të paisura me botë të pasur shpirtërore, paraqiten madhështore dhe tepër serioze. Për vlerat e tyre artistike dy ikona të shën Mërisë odigitria, ajo e Mborjes, shumë e dëmtuar, dhe ajo e paraklisit Bllashtojna, e një shpelle të Prespës, me plot të drejtë mund të radhiten ndër më të bukurat e stilit klasik bizantin në përgjithësi.

Piktura bizantine vepronte sipas temave e kanoneve të sanksionuara nga rregulla të rrepta të dogmës kishëtare si përsa u përket temave e subjekteve ashtu edhe përsa i përket mënyrës së parafytyrimit të skenave dhe figurave. Çdo shprehje e artit të kultivuar në mesjetë bëhej nëpërmjet tematikës fetare. Në këtë kontekst janë shprehur edhe ndjenjat, idetë, konfliktet, kontradiktat ideore të atyre shekujve. Piktorë të ndryshëm mesjetarë të ndrydhur nga kanonet dogmatikë kishëtare të stilit bizantin janë përpjekur të shprehin ndjenjat, mendimet e tyre me anë të formës së përkryer, të linjës, të koloritit e ndonjëherë edhe duke mos i respektuar kanonet tematike. Këto fenomene i shohim gjatë gjithë historisë së pikturës bizantine edhe në Shqipëri.

Piktura e shek. XIII në Shqipëri, si ajo e ikonave dhe ajo e miniaturës së dorëshkrimeve, nuk paraqitet më me atë finesë të theksuar nga ana artistike si ajo e shekullit të mëparshëm. Kjo gjendje e pikturës sonë të shek. XIII mund të thuhet se përputhet gadi plotësisht me atë të pikturës po të këtij shekulli të viseve të tjera ballkanike në të dyja gjinitë që po ekspozojmë.

Arti i epokës së sundimit të Makedonëve dhe të Komnenëve por sidomos, ai i kohës së paleologëve, prej gjysmës së dytë të shek. XIII dhe gjatë shek. XIV, që pati lulëzimin dhe zhvillimin e vet në Kostandinopojë dhe në Selanik, pati një ndikim të thellë edhe në monumentet e kulturës shqiptare të kohës, mbi pikturën monumentale, mbi ikonën e mbi letërsinë agjiografike por jo mbi miniaturën. Vetëm se këtu nuk është fjala për një riprodhim të thjeshtë të elementëve e tipareve bizantine në një ambient që qëndroi thjeshtësisht pasiv.

Ikona e Shqipërisë e ruajtur nga shekulli XIII karakterizohet nga tipare që përbëjnë stilin thjeshtë bizantin me figura të zgjatura, të imaterializuara me qëndrime frontale, trajtuar me linja të thyera, me shumë stolisje në rrobet, me tipa të sansionuar me përmbajtje të theksuar serioze.

Portretet e këtyre ikonave janë modeluar me konture të theksuara e me ngjyra të errëta karnacioni me okër të zbetë e me kontraste. Këto figura, ndonëse pa gjallëri fizike, paraqiten të realizuara me art, me vështrime sugjestive.

Ky stil i ikonës në Shqipëri, si edhe në viset e tjera ballkanike, pëson ndryshime qysh nga fundi i shek. XIII.

Figurat në ikonat e shek. XIV të Shqipërisë paraqiten me tipare artistike më të përparuara drejt realizmit, në frymën e asaj rryme artistike përparimtare që në Bizant u quajt «rilindja e artit bizantin».

Këtë rrymë bizantinologët e lidhin me çlirimin e Kostandinopojës nga latinët (1261), kurse në Shqipëri, ajo duhet të lidhet edhe me zhvillimin e fuqive ekonomike e shoqërore të vendit, me fuqizimin e klasës sunduese feudale shqiptare, me rritjen e fuqizimin e qyteteve dhe me krijimin e principatave feudale shqiptare.

Fenomeni i shkëputjes nga vartësia politike e Bizantit ndodh edhe në fushën e pikturës, e cila duke ruajtur nga njëra anë tiparet e përbashkëta të origjinës, fillon të vejë në dukje dhe karakteristika të saj të veçanta. Shekulli i XIV në Shqipëri karakterizohet me ndërtimin e një numri të rëndësishëm monumentesh të kultit të krishterë, por nga ikonat që stolisnin ato monumente ruhen fare pak, ato nuk i arrijnë

të 20 copët, dhe janë nga ato të mëdhatë të ikonostasit, përveç një te vogla.

Në Shqipëri nuk konstatohet të ketë patur ikona të vogla me skenat e «festave të mëdha» nga ungjilli ose me figurat e apostojve gjysëm figurë mbi ikonostasët e epokës paraturke. I vetmi ikonostas prej druri i ruajtur i shek. XIV me të gjithë ikonat është ai i shën Mërisë së Maligradit, dhe ky pa ikona të vogla mbi ato të mëdhatë, ndofta për faktin se, skenat e «festave të mëdha» në kishat paraturke ishin të pikturuara mbi suva në faqet e mureve, dhe nuk shihesh e nevojshme që ato skena të përsëriteshin në ikona të vogla mbi ato të mëdhatë. Mbas pushtimin otoman, kur ekonomia paraqitej thellësisht e rrënuar nuk ishte e mundur të ndërtoheshin kisha të mëdha dhe t'i stolisnin me piktura murale. Ndofta për të mos munguar skenat e festave të mëdha në ato pak kisha të vogla e të vobegta që ndërtoheshin, kleri kërkonte t'i pikturojë skenat në ikona të vogla dhe filluan të vendosen këto mbi ikonostaset e kapelave që qenë të parat ndërtime kulturi mbas ngjarjes së okupacionit.

Më vonë, kur vendi filloi relativisht të mëkëmbej nga ana ekonomike. ndonëse kishat filluan të ndërtoheshin të mëdha dhe të stoliseshin me piktura murale, përdorimi i ikonave të vogla me «festat e mëdha» në miniatyre mbi ikonostaset mbeti si një traditë e një stolisjeje të zakonshme, që vazhdoi deri në shekullin tonë.

Ikona të shek. XIV që ruhen deri më sot në Shqipëri janë ato të Beratit dhe ato të rrethit të Korçës. Përveç ikonës së Pagzorit të kishës së Maligradit dhe asaj të shën Mëhillit të kishës së fshatit Opar, paraqitur me gjithë trupin në këmbë, të gjitha ikonat e tjera, janë pikturuar në gjysëm figurë.

Figurat e këtyre ikonave, në ndërtimin e tyre, karakteristikat kryesore në përgjithësi i kanë gadi të njejta dhe të njohura në ikonografinë bizantine. Figurat janë dhënë brenda kornizës, vendosur në mënyrë simetrike dhe shumica me qëndrim frontal vertikal.

Figurat e ikonave të shek. XIV të Shqipërisë karakterizohen nga tipare artistike më të përparuara, që vërehen në ndërtimin e tyre arritur më anë linjash shumë elegante, që evidencojnë bukur format e tyre voluminoze.

Ndonëse nga njëra anë këto figura janë trajtuar me tipare më të përparuara, sidomos në modelimin e portreteve të tyre, për arsye të kompozimit me qëndrim të rreptë vertikal, statik, dhe me shprehje psikologjike të një bote të veçantë shpirtërore, që reflektohet në vështrimet e fuqishme të tyre, ato marrin një pamje akademike, solemne.

Të këtij stili janë të gjitha ikonat e Shqipërisë të shek. XIV, por për tiparet më

interesante që vërehen në plastikën e avancuar e siluetën harmonike në vështrimin e fuqishëm të syve të mëdhenj me vetulla të larta, që e mbërthejnë spektatorin, bie fort në sy figura e Shën Mëhillit të Mborjes, në madhësi natyrale, e rrallë për bukurinë e saj artistike. Me të vërtetë kjo vepër mund të konsiderohet nga më të bukurat prodhime artistike në gjithë krijimtarinë artistike të territorit bizantin në përgjithësi gjatë shek. XIV.

Në këto ikona të shek. XIV të Shqipërisë, vërehen edhe disa veçori vendase, që i bëjnë të ndryshojnë mjaft nga ikonat analoge të vendeve të tjera.

Veçoria kryesore në artin e këtyre ikonave konsiston në trajtimin plastik më të avancuar që i ka përshkuar figurat, e që ka kontribuar dhe në tipizimin e figurave, duke i bërë ato të ndryshojnë nga tipat analogë të ikonave të huaja.

Por kjo veçori që vërehet në ikonat e Shqipërisë të shek. XIV, nuk mund të konsiderohet se i largon ato nga stili bizantin, sepse në fakt ato i ruajnë të gjitha tiparet karakteristike të pikturës bizantine, por mund të thuhet se ajo formon një tipar të fazës më përparimtare të artit të rilindjes bizantine, që ka arritur të zhvillohet në ikonën e Shqipërisë në atë shekull.

Përveç asaj veçorie të përgjithshme të ikonave të shek. XIV, të tërheq në mënyrë të veçantë vëmendjen një ikonë e Manastirit të Shën Mërisë së Postenanit, ikona e shën e Premtes e cila nga mënyra e kompozimit dhe e trajtimit duhet t'i vishet shek. XIV. Kjo ikonë paraqitet me tipare të theksuara veçorie, diçka me art naiv në krahasim me ikonat e tjera të atij shekulli, por me një bukuri tërheqëse. me qendrim frontal dhe të rreptë vertikal, me një qafë të gjatë e të bukur, si në figurat e artit egjiptian, me sy të mëdhenj në formë bajamje e me qerpikë të zez, që përherë të parë i hasim të përdoren në ikonën tonë. Kjo figurë me një trajtim dekorativ, ka një bukuri prej tiparesh origjinale të vendeve tona malore. Brerorja e saj është ndërtuar prej grundi në reljef dhe stolisur me motive florale, si dhe gjithë sfondi i figurës, që sot paraqitet gadi i bardhë, sepse ari me të cilin ka qënë veshur është fshirë. Anash ikonës, në formë kuadratesh, janë pikturuar në miniatuere skena nga jeta e shën e Premtes. Megjithëse figura është dëmtuar diçka në veshjet, nga plasja e ngjyrave, ajo e ruan madhështinë e bukurisë së saj origjinale. Me këtë vepër piktori anonim i malësive shqiptare ndofta ka dashur të largohet nga arti i zakonshëm dhe të japi diçka thilajse gadi krejt të veten, simbas gustos dhe imagjinatës malsore shqiptare.

Por atë zhvillim që njohën piktura monumentale dhe ikona në Shqipëri gjatë shek. XIV, nuk e njohu miniatuara e mbishkrimeve. Kështu kodet e Beratit të shek. XIV, që stolisën me miniatuërë, po të krahasohen me miniaturën e kodeve të shek. XI dhe XII, duken të një teknike dhe të një arti me të ulët. Me gjithë këtë, në krahasim me

miniaturën e shek. XIII, në atë të shek. XIV vërehet një farë ngritje nga ana artistike, që bijë në sy në kompozimet e lira të figurave, realizuar relativisht me plastikë të mirë, me linja të lakuara, me pozicione natyrale e me ngjyra të kultivuara, përdorur dhe me gradacione. Në figurat pikturuar me akuarel e monokrome, trajtimi realizohet kryesisht me anë të linjës që lot rolin kryesor në dhënien e formave dhe të volumit (KOD. BR. 38).

Ky zhvillim në Shqipëri në fushën kulturele, si dhe në fushat e tjera ekonomike shoqërore, u ndërpre në mënyrë të thellë me pushtimin otoman në gjysmën e shek. XV.

Me gjithë rrethanat shumë të vështira që u krijuan nga pushtimi i huaj, populli shqiptar gradualisht fillon ta marrë vehten dhe aty nga mezi i shek. XVI, fillon; përsëri t'i zhvillojë traditat e tij të shkëlqyera kulturalo-artistike. Në këtë kohë në Shqipëri çfaqen përsëri piktorë shqiptarë me aktivitetin e tyre artistik, si në pikturën murale dhe në ikona. Në veprat e tyre ruhen edhe sot mbishkrime autografe me të dhëna interesante rreth kohës së pikturimit dhe rreth artistëve që i kanë pikturuar.

Në këtë periudhë historike në Shqipëri nuk vazhdoi të zhvillohet më arti i miniaturës së dorëshkrimeve, sepse këto filluan të zëvendësohen me libra të shtypit.

I pari ndër piktorët shqiptarë, që u çfaq në këtë periudhë historike, qe Onufri i Neokastrës (Elbasanit), me një aktivitet artistik të mirëfilltë si në pikturën murale edhe në ikonë. Pas Onufrit vijnë piktorë të tjerë, si Nikolla, bir i Onufrit, Joani, bashkëpunëtor i Nikollës në pikturë, dhe të tjerë anonimë të cilët kanë stolisur me piktura ndërtesa të kultit në vise të ndryshme të Shqipërisë.

Në veprën artistike të Onufrit dhe të birit të tij Nikollës fillojnë të krijohen ansamblet e ikonave të vogla të ikonostaseve, të cilat vazhdojnë të shumohen gradualisht gjatë shekujve prej piktorëve shqiptarë që çfaqen më vonë.

Duke mos llogaritur këtu pikturën murale të Onufrit, nga krijimtaria në ikonë e këtij piktori të shquar, ne njohim të ruajtura në Shqipëri ikonat e ikonostasit të kishës Vangjelista dhe ato të ikonostasit të kishës së shën Mitrit, kurse nga ato të birit të tij Nikollës njohim vetëm ikonat e vogla të kishës Vlaherna. Të tria këto kisha ndodhen në kala të Beratit.

Piktura e Onufrit lind e zhvillohet në vazhdim të traditës së artit të madh bizantin, por talenti i fuqishëm i këtij mjeshtri, nën ndikimin e ideve të reja të krijuara nga rrethanat politike të vendit dhe të realizimeve të shkëlqyera të artit perëndimor të kohës, i ndryshon normat e paradiktuara të pikturës së vjetër bizantine dhe fut elemente të

jetës së gjallë. Onufri arrin kështu të krijojë një art të vetin, me tipare individuale, një art të përshkuar prej një fryme me prirje realiste; me realizime, që nga ana artistike arrijnë maja të larta me interes të veçantë.

Ndërsa në kompozimin e skenave të gjithë ikonës, Onufri ruan traditën bizantine, modelimet e portreteve dhe ansamblet e skenave të veçanta ai i realizon në mënyrë të ndryshme me elemente zhanri, gjë që mund të vërehet në shumë ikona të tij, si p.sh. në skenën e veçantë «Larja e foshnjës nga dadilat" në skenën «lindja e Krishtit», ku vërehen lëvizje e veprime natyrale ashtu siç ngjan në natyrë.

Figurat në skenat e ikonave të Onufrit paraqiten të kompozuara me pozicione reale, me lëvizje dhe mimikë të gjallë, me shprehje psikologjike të thellë, duke marrë pjesë në ngjarjet që pikturohen në skenë (shembull janë grupi i apostojve në skenën «Ngjallja e Llazarit», virgjëreshat në ikonën «Hyrja e shën Mërisë në tempull» etj.).

Në gjithë veprën e Onufrit, por sidomos në ikonat, ku ngjyrat ruhen të freskëta edhe sot, Onufri shquhet si mjeshtër i dalluar i ngjyrave duke i realizuar ato të kultivuara në maksimum, të ngrohta e transparente, me gradacione, në mjaft raste edhe me tone të fuqishme, tingullonjëse dhe të kombinuara me harmoni.

Përdorimi i kontrastit dritë-hije në skenat e ikonave të Onufrit është një element i ri që dëshmon për prirjen realiste të veprës së këti artisti. Kjo vihet re p.sh. në «Ikonën e shpërfytyrimit» ku bije në sy më qartë mjeshtëria origjinale e Onufrit në realizimin e këtij kontrasti si mbi shkëmbijt e thepisur dhe mbi figurat.

Përveç tipave të sanksionuar në pikturën e Kishës Lindore, me individualitet të ndryshëm, ndër tipat e Onufrit spikatin edhe fizionomi të ngjashme me ato të popullatës së Shqipërisë së Mesme. Kjo takohet në shumë figura të tij dhe dëshmon qartë për një ndikim të artistit nga ambienti ku ai punoi e krijoi.

Trajtimi i figurave në ikonat e Onufrit me mimikë e lëvizje të gjalla, me shprehje të fuqishme shpirtërore dhe me tinguj të fortë e të fuqishëm të ngjyrave, ndofta në një farë mase reflekton gjendjen shpirtërore të artistit të formuar nën ndikimin e shqetësimit të madh të të gjithë popullit shqiptar që duke filluar nga mezi i shek. XV iu nënshtrua një gjendjeje robërie të rëndë, shkatërimtare e të pamëshirëshme.

Stili artistik i Onufrit me përsosjen e tij të lartë, influenoi thellësisht dhe u ndoq nga të gjithë piktorët që erdhën me pas nga biri i tij Nikolla e të tjerë. Në Shqipëri u krijua kështu një rrymë artistike e qartë, me realizime të bukura; por në rrethanat shumë të vështira që pasuan kjo rrymë nuk pati mundësi vazhdimi e zhvillimi.

Gjatë shek. XVII, ikonografët shqiptarë me krijimtarinë e tyre artistike stolisnin me ansamble ikonash një shumicë të rëndësishme monumentesh në Shqipërinë e mesme e të jugut, si në Berat, Voskopojë, Vithkuq, Lubonjë, Postenan, Radovë, në krahinën e Lunxhërisë e krahina të tjera.

Në ikonat e shek. XVIII, që janë të shumta, vërehet vazhda e traditës bizantine në art, e cila vinte gradualisht duke u banalizuar por njëkohësisht vihen re elementë të kohës, ndonëse të ulta nga ana artistike.

Ne këtë kohë në Shqipëri shohim të prodhohen ikona prej artistësh artizanë, të cilët bëjnë përpjekje për të imituar ikona të stilit bizantin. Këto ikona karakterizohen nga një stil naiv, por me interes historik dhe tërheqëse për naivitetin e tyre.

Shek. XVIII në Shqipëri karakterizohet nga një zhvillim mjaft i rëndësishëm ekonomiko-shoqëror, me rritjen e tregëtisë e të qyteteve, me ndërtimin e shumë institucioneve kulti dhe me stolisjen e tyre me vepra arti të gjinive të ndryshme. Historikisht dihet se në këtë kohë kemi forcimin e pozitave të feudalëve shqiptarë dhe një qetësim relativ të vendit.

Me mijëra janë ikonat dhe skenat e pikturës murale, që stolisnin në Shqipëri monumentet e këtij shekulli si dhe të shek. XIX. Nga mbishkrimet autografe, që ruhen në këto ikona, vërtetohet se janë vepra autorësh shqiptarë, familjet e shumë prej të cilëve vazhdojnë te jetojnë edhe sot. Ndër këta piktorë dallohen David Selenica, nga Selenica e Kolonjës, Kostandin Shpataraku, nga Shpati i Elbasanit, korçarët Kostandin e Athanas Zografi me bijt e nipat e tyre, me origjinë nga Potkozhan i Mokrës, grabovarët Gjergj e Joan Çetiri, me bijtë e nipat e tyre, me origjinë nga Lavdari i Oparit, Nikolla Guga, me origjinë nga fshatrat e Myzeqesë, etj.

Ikonat e piktorëve shqiptarë në shek. XVIII në Shqipëri, që i kemi quajtur të shkollës lokale të Korçës, siç konstatohet në përgjithësi për gjithë pikturën e këtij shekulli, për veç traditës vendase, paraqesin ndikime të shumta nga piktura e Athosit dhe nga arti përëndimor i kohës. Tek piktorët korçarë Kostandin e Athanas Zografi vërehen ndikime dhe nga stili barok. Ka edhe pak ikona të shpërndara të shkollës së Kretës.

Në krahasim me ikonat e shekujve të mëparshëm ato të shekujve XVIII paraqiten të një teknike më të ndërlikuar. Në to nuk vërehet më linja grafike dhe simetria bizantine. Trajtimi i figurave të tyre realizohet me vizatime më reale, portretet modelohen me më shumë plastikë. Ambienti arkitektonik në skenë paraqitet i modeluar, në të nuk haset më perspektiva e kundërt, dhe shumohen elementet etnografike.

Ndërmjet tyre një interes të veçantë paraqet ikona e Kostandin Shpatarakut «Shën Gjon Vladimiri» e cila prap se prap ruan një tërësi më klasike. Aty përzihen elemente të ditës, njerëz me veshje sipas modës perëndimore të shek. XVIII e të tjera, të përziara me elementë të lashta të traditës bizantine e të legjendës së atij shenjtë. Por ikona paraqet interes historik sepse përveç të tjerave jepet për herë të parë figura e princit shqiptar të shek. XIV Karl Topisë.

